



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 190, datë 16.12.2020

**PËR
MIRATIMIN E FORMATIT TË LICENCAVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË
FONDEVE, DEPOZITARIT TË FONDEVE DHE TË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMEVE KOLEKTIVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 238, 239, të Kreut 14, të Ligjit 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive” dhe të pikës 7, neni 57, të Rregullores nr. 112 datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e formatit të ri të licencës për:

- Shoqëritë administruese të fondeve, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë;
- Depozitarin e fondeve që ushtron veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë;
- Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike, që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

L I C E N C Ë
Nr. __, datë _____

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të pikës 2, të nenit 13, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” si dhe Vendimit/Vendimeve nr. __, datë _____ të Bordit AMF,

L I C E N C O N:

SHOQËRINË ADMINISTRUESE TË FONDEVE “ _____ ” PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARINË E

ADMINISTRIMIT TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE;
ADMINISTRIMIT TË FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE VETËM PËR KLIENTËT PROFESIONISTË DHE TË KUALIFIKUAR;
ADMINISTRIMIT TË FONDEVE TË PENSIONIT VULLNETAR;
ADMINISTRIMIT TË PORTOFOLEVE TË INVESTIMEVE
KËSHILLIM NË INVESTIME.

Licenca është e patransferueshme.
Vlefshmëria e licencës është për një periudhë pa afat.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

L I C E N C Ë

Nr. __ datë _____

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të pikës 2, të nenit 13, të Ligjit Nr.9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të Ligjit Nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” si dhe Vendimit nr. __ datë _____ të Bordit të AMF,

L I C E N C O N :

SHOQËRINË “ _____ ”

PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË DEPOZITARIT TË

SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE.
FONDEVE TË INVESTIMEVE ALTERNATIVE, PËR KLIENTËT PROFESIONISTË
DHE TË KUALIFIKUAR.
FONDEVE TË PENSIONIT VULLNETAR.

Licenca është e patransferueshme.
Vlefshmëria e licencës është me afat të pacaktuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

L I C E N C Ë

Nr. __ datë _____

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 13, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 62, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin Nr. __, datë _____,

L I C E N C O I

**FONDIN E INVESTIMIT/SHOQËRINË E INVESTIMIT
“ _____ ” ME PJESËMARRJE TË HAPUR/ ME
PJESËMARRJE TË MBYLLUR/ ME INTERVALE, ME
OFERTË PUBLIKE/ ME OFERTË PUBLIKE NË TITUJ TË
TRANSFERUESHËM**

si sipërmarrje e veçantë/obmrellë, kryesore/furnizuese

**administruar nga Shoqëria Administruese “ _____ ” me
Licencë Nr. __, datë _____**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV